VENDIM
Nr. 500, datë 27.7.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJË OBJEKTI ARSIMOR NË BASHKINË VORË DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 678, datë 6.12.2023; nr. 358, datë 5.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla e mesme "Isa Boletini", Bashkia Vorë, në masën 282 864 046 (dyqind e tetëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi, në masën 56 572 809 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në masën 129 974 554 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla e mesme "Isa Boletini", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

2/2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi, në masën 92 452 637 (nëntëdhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla e mesme "Isa Boletini", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.

3. Caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, *sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2,* të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj